



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura V
Sesioni vjeshtor

Kryesia e Kuvendit

P-042

Prishtinë, më 28 tetor 2015, në orën 12:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla C -301

PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË KRYESISË SË KUVENDIT, E MBAJTUR MË 28 TETOR 2015

Në mbledhje morën pjesë: Kadri Veseli, kryetar i Kuvendit; Xhavit Haliti, Sabri Hamiti, Aida Dërguti dhe Duda Balje, nënkryetarë të Kuvendit.

Nga grupet parlamentare: Adem Grabovci, Ismet Beqiri dhe Myfera Shinik.

Nga Kabineti i kryetarit të Kuvendit: Blerim Latifi, Dhurata Hoxha dhe Avni Bytyçi.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

Nga Administrata e Kuvendit: Ismet Krasniqi, Xheladin Hoxha, Sali Rexhepi, Shefki Shoshaj dhe Musli Krasniqi.

Nga Zyra e BE-së: Blerta Bejtullahu,

Nga OSBE-jas: Floriana Shala.

Mbledhjen e drejtoi **Kadri VESELI**, kryetar i Kuvendit.

Kryetari i njoftoi të pranishmit se presidenti i Austrisë do ta vizitojë Kosovën dhe ka shprehur gatishmërinë që me një fjalë rasti t'u drejtohet edhe deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Pas njoftimit të kryetarit, Kryesia e Kuvendit, me pëlqimin e kryetarëve të grupeve parlamentare, vendosi që Kuvendi të mbajë seancë të veçantë të enjten, më 29 tetor 2015, me fillim në orën 9:30, me këtë rend dite:

1. Adresimi i Presidentit të Austrisë, z. Heinz Fischer, deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Kryetari e mbylli mbledhjen e Kryesisë në orën 12:25 minuta.

Kryetari i Kuvendit

Kadri VESELI

Procesverbalin e hartoi:

Drejtorja për Çështje Plenare dhe Procedurale